

KOSOVA SOT, E mërkurë, 7 Janar 2009

SOCIALE

E MËRKURË, 7 JANAR 2009

## DËSHTOJNË STUDIMET MASTER NË GJUHËN ANGLEZE NË FAKULTETIN FILOZOFIK


# PËR STUDIME MASTER DUHET TË PRITET VITI TJETËR AKADEMIK

Nga ky muaj ishte paraparë që në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në Drejtimin e Shkencave Politike dhe në Psikologji të fillojnë studimet master në gjuhën angleze, por ky projekt duket se nuk ka gjasa të fillojë këtë vit akademik

**A**s gjatë këtij muaji nuk do të fillojnë studimet master në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në drejtimin e Shkencave Politike dhe në Psikologji. Edhe pse ishte planifikuar që në këto dy drejtime më të kërkuara nga studentët, mësimi të organizohet në gjuhën angleze dhe stafi akademik të sigurohet nga qeveria austriake, kjo punë nuk është bërë. Dekani i Fakultetit Filozofik, Ramush Mavriqi, ka bërë të ditur se ata janë të interesuar për sigurim të cilësisë së mirë të mësimdhënies e jo të prodhojnë vetëm diploma. "Pikërisht për këtë shkak, ne si fakultet, nuk kemi mundësi që të gjithë studentët t'i pranojmë në studime master dhe të organizojmë çdo vit studime të tilla", ka pohuar dekani Mavriqi. Sipas tij, për drejtimet e Shkencave Politike dhe Psikologji të nivelit master ende nuk është bërë asgjë konkrete dhe nuk është mbajtur as mbledhja për përzgjedhjen e stafit akademik që do të ligjëronte.

### Dekani: Fakulteti nuk ka kuadro për master

"Profesorëve austriakë iu duhet së



paku gjashtë muaj kohë për përgatitje, ngase ata nuk vijnë për të ligjëruar në UP ad hok", ka sqaruar Dekani Mavriqi. "Në këto drejtime do të jenë nga 10 lëndë dhe numri i studentëve që do të pranohen në këto studime do të jetë i kufizuar. Mirëpo, deri më tani asnjë nga profesorët nuk është paraqitur në këto programe", ka thënë numri një i Fakultetit Filozofik. Po ashtu, mësohet se në muajin mars të vitit 2007 kanë filluar studimet master në pesë programe dhe tash kjo gjeneratë është duke e vazhduar semestrin e tretë. "Ne si fakultet nuk kemi kapacitete kadrovike që në një vit akademik t'i pranojmë dy gjenerata

në master. Andaj, në përjashtim të drejtimin të Historisë dhe të Pedagogjisë, në të gjitha drejtime të tjera kemi mungesë të kuadrit adekuat për mësimdhënie në master", ka thënë dekani Mavriqi. Sipas tij, në këto studime japin mësim bartësit e lëndëve, por ka edhe asistentë me përvojë. Pak më mirë, sa i përket cilësisë së studimeve dhe stafit akademik, qëndrojnë Drejtimi i Shkencave Politike dhe ai i Psikologjisë, pasi që këto dy projekte janë realizuar përmes projekteve të Tempusit. Sipas tij, tashmë janë duke i bërë përgatitjet që në vitin e ardhshëm në të gjitha drejtime të fillohet me këto studime.

### "VUS Austria", studime master në tri fakultete

Por, ndryshe mendon menaxheri i "VUS Austria", Bud Dedaj, sipas të cilit për vitin e ardhshëm akademik "VUS Austria" ka paraparë të organizojë studime master në tri fakultete, në Fakultetin Juridik, Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin e Mjekësisë. Dedaj ka potencuar se ka zhvilluar takime e konsulta të vazhdueshme me dekanët e fakulteteve përkatëse, si dhe me rektorin e UP-së, Enver Hasani. Sa i përket Fakultetit Filozofik dhe studimeve master, Dedaj tha se në Fakultetin Filozofik studimet master, sipas projektit "VUS Austria" do të organizohen në drejtimin e Psikologjisë dhe të Shkencave Politike. Projektet për këtë fakultet dhe të tjerat pritet të startojnë tek në vitin e ardhshëm akademik, pra 2009/10. Sipas tij, të gjitha programet e studimeve master do të organizohen në gjuhën shqipe, por nuk përjashtohen edhe ligjërata në gjuhën angleze. "Për këto studime do të këtë shumë vizita studimore për të gjithë profesorët e UP-së në institucione të ndryshme partnere në Austri, ku ata do të përgatisin materiale të ndryshme në formë të skripteve që do t'u ndihmojnë në ligjërata.

V. REXHA